



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 600/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.09.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e shoqërisë “Avduli” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-20370-05-02-2019, me objekt: *“Zbatimi Projekt-Preventiv për Eficiencën e Energjisë i Ndërtesës Ekzistuese 4-KT, në Bashkëpronësi, Pallati nr. 3 (Fizarmonike), Lagje 1, në Qëndër të Qytetit Krumë”*, me fond limit 25.785.910 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 07.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Has.

Ankimues: “Avduli” sh.p.k
L.10 Korriku, Rr. Perlat Rexhepi, Objekt 3-katësh, Kati I, Vlorë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Has.
Sheshi “Dëshmorët e Hasit”, qyteti Krumë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-20370-05-02-2019, me objekt: “*Zbatimi Projekt-Preventivit për Eficiency e Energjisë i Ndërtesës Ekzistuese 4-KT, në Bashkëpronësi, Pallati nr. 3 (Fizarmonike), Lagje 1, në Qëndër të Qytetit Krumë*”, me fond limit 25.785.910 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 07.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Has.

II.2. Në datën 04.07.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|----------------------------------|
| 1. “Avduli” sh.p.k. | 17.834.594,00 lekë, skualifikuar |
| 2. “Pe-Vla-Ku” sh.p.k | 22.819.966,58 lekë, kualifikuar |
| 3. “Lala” sh.p.k | 25.575.113,00 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomik “Avduli” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me argumentat si më poshtë vijon:

Operatori Juaj Ekonomik skualifikohet për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori nuk ka paraqitur (bashkëngjitur) Ekstraktin Historik as Ekstraktin e Thjeshtë të saj në SPP, si kërkesë e DST, Kriteret e Përgjithshme dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika

2.1. Per kapacitetin ligjor/ profesional i operatorëve ekonomikë, nga ku kërkohej që të kishte: "Objekti i "Ndertim" duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik", nga ku do të gjykohej (vertetohej) përmes paraqitjes (bashkëngjites) së ekstraktit historik dhe Ekstraktit Thjeshte të kompanise për fushën e veprimtarisë dhe historikun e saj.

2. Skedari me emertimin KAMIONCINE_TR_5429I_SHOQERIA_AVDULI_SHPK_VLORE i paraqitur nga OE, mjet ne pronesi të OE nuk plotëson kërkesën e AK që mjeti të jëtë me kapacitet mbajtës dhe transportues mbi 3 ton (fakt 2130 kg sipas lejes së qarkullimit mjetit).

Sa më sipër, Operatori Ekonomik "AVDULI" Shpk, nuk plotëson një nga kriteret e DST, pika 2.3 Per kapacitetin teknik, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion... :

3. Skedari me emertimin KAMIONCINE_AA782DF-SHOQERIA_AVDULI_SHPK, i paraqitur nga OE tregon për mjetin e marrë me qira nga OE, i cili nuk plotëson kërkesën e AK që mjeti të jëtë me kapacitet mbajtës dhe transportues mbi 3 ton (fakt nen 700 kg sipas lejes së qarkullimit mjetit).

Sa më sipër, Operatori Ekonomik "AVDULI" Shpk, nuk plotëson një nga kriteret e DST, pika 2.3 Per kapacitetin teknik, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion... :

4. Në Skedarin me emertimin KAMIONCINE_ME_QERA_SHOQERIA_AVDULI_SHPK_VLORE me targa TR5154 L, mungon liçenca kontraktorit (qeradhenesit), është paraqitur dokumentacioni mjetit, per te cilin (Per mjetin kamioncine, me targa TR5154 L), i marre me qira, nuk eshte paraqitur licence e Operatorit qiradhenës. Kjo vjen ne kundershtrim me nenin 41(citim: Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.), te ligjit Nr. 8308, date 18.03.1998 "Per transportet rrugore", te ndryshuar. Neni 5 Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës. Gjithashtu UDHËZIM-i Nr. 15, datë 24.7.2007, "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR", i ndryshuar, Neni 29, "Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira brenda vendit", thuhet që: "Licenca për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit lëshohet për subjekte fizike dhe juridike". Kjo licencë vlen edhe për transportin e mallrave për llogari të vet brenda vendit.

Sa më sipër, Operatori Ekonomik "AVDULI" Shpk, nuk plotëson një nga kriteret e DST, pika 2.3 Per kapacitetin teknik, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion... :

5. Skedari me emertimin KAMION_AA258EV_M me kontrate qeraje 14 ton mungon licence referimi licences se kamionit, mungon liçenca kontraktorit (qeradhenesit), është paraqitur dokumentacioni mjetit, i marre me qira, nuk eshte paraqitur licence e Operatorit qiradhenës. Kjo vjen ne kundershtrim me nenin 41(citim: Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i

ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.), te ligjit Nr. 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, te ndryshuar.

Sa më sipër, Operatori Ekonomik “AVDULI” Shpk, nuk plotëson një nga kriteret e DST, pika 2.3 Per kapacitetin teknik, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion... :

Nuk plotësohen kushtet e UDHËZIMIT Nr.15, datë 24.7.2007,“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”,i ndryshuar, Neni 29, “Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira brenda vendit”, citim: “Licenca për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit lëshohet për subjekte fizike dhe juridike” . Kjo licencë vlen edhe për transportin e mallrave për llogari të vet brenda vendit.

6. Skedari me emertimin KAMION_VL_5873_C me kontrate qeraje, me kapacitet 18 ton mungon licence referimi licences se kamionit, mungon liçenca kontraktorit (qeradhenesit), është paraqitur dokumentacioni mjetit, per te cilin i marre me qira, nuk eshte paraqitur licence e Operatorit qiradhenës. Kjo vjen ne kundërshtim me nenin 41(citim: Transporti I mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.), te ligjit Nr. 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, te ndryshuar.

7. Ne skedarin SHTOJCA_5_7_10_B, fq.4-5(shtojca 10) deklaratë mbi disponimin e makinerive, Operatori Juaj deklaroi (shprehet): “Deklaroj se zoteron mjetet pajisjet teknike dhe asete te tjera fizike per te realizuar kontraten me objekt: “Sistemim i shesheve dhe rrethim i varrezave te fshatrave Rranxa, Hajmel, Nenshate, Dheu i Lehte”, cfarë tregon se kjo deklaratë nuk i përket objektit tenderimit që ka zhvilluar bashkia Has (“Zbatimi Projekt-Preventivit per Efiçencen e Energjise i Nderteses Ekzistuese 4-KT. ne Bashkepronesi, Pallati nr. 3 (Fizarmonike), Lagje 1, ne Qender te Qytetit Krume”)

Operatori Ekonomik “AVDULI” Shpk, nuk plotëson një nga kriteret e DST, pika 2.3 Per kapacitetin teknik, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion :

II.3. Në datën 08.07.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton s’kualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Shoqeria “Avduli” shpk, bazuar ne Ligjin e Prokurimit Publik nr.9643 date 20.11.2006 te ndryshuar, Neni 63, pika 2 dhe ne VKM-ne nr.914 date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, Neni 78, ju paraqet per shqyrtim ankesen prezente.

Ne daten 03.06.2019 Autoriteti Kontraktor “Bashkia Has” zhvilloi proceduren e hapur te Prokurimit me objekt: “Zbatimi Projekt-Preventivit per Efiçencen e Energjise i Nderteses Ekzistuese 4-KT. ne Bashkepronesi, Pallati nr. 3 (Fizarmonike), Lagje 1, ne Qender te Qytetit Krume” me fond limit: 25,785,910, (Njëzet e pesëmilion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e nëntëqind e dhjetë) lekë pa TVSH, ku shoqeria “Avduli” shpk u paraqit si ofertues, duke ofertuar per kryerjen e punimeve dhe sherbimeve me cmimin e ofertes ne vleren prej 17834594.00 leke. Pas shqyrtimit te vleresimit te ofertave Autoriteti Kontraktor vendosi skualifikimin e ofertes te

paraqitur nga shoqeria "Avduli" shpk, duke pretenduar si shkak per skualifikimin e shoqerise sa me poshte:

Pike se pari sqarojme Komisionin e Vleresimit te Ofertave dhe Autoritetin Kontraktor se nga subjekti jone eshte kerkuar justifikim oferte per oferte anomalisht te ulet, fakt i cili presupozon qe oferta jone ka qene e vlefshme pasi nuk mund te kerkosh justifikim oferte per oferta te pavlefshme, nuk ka kuptim. Dhe pasi ne kemi paraqitur sqarimet tona per oferte anomalisht te ulet Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka vendosur skualifikimin e ofertes tone per arsye qe nuk ka lidhje me oferten anomalisht te ulet, duke shkelur ne kete menyre haptazi Ligjin e Prokurimit Publik, pasi ne momentin qe na eshte kerkuar justifikim oferte do te thote qe skualifikimi jone duhet te behej vetem per faktin qe justifikimi i ofertes tone nuk do te merrej ne konsiderate nga Autoriteti Kontraktor, por perderisa justifikimi i ofertes tone eshte marre parasysh nga Autoriteti Kontraktor, nuk ka kuptim te skualifikohemi per arsye qe nuk kane lidhje me justifikimin e ofertes. Lidhur me pretendimin se subjekti "Avduli" shpk nuk ka paraqitur Ekstraktin Historik as ekstraktin e thjeshte te saj ne SPP sqarojme se, Ekstrakti Historik dhe i thjeshte nuk kerkohen si pjese e DST-se por tashme kerkohet Shtojca nr.8 e cila plotesohet dhe zevendeson kriteret e pergjithshme. Persa i perket pretendimit qe objekti i veprimtarise se shoqerise "Ndertim" do te vertetohet nepermjet Ekstraktit, kjo nuk eshte e vertete pasi objekti i veprimtarise te subjektit tone mund te vertetohet shume thjeshte ne sistemin e QKB-se ku mund te shkarkohet edhe Ekstrakti i thjeshte edhe Ekstrakti Historik. Pra, Komisioni Vleresimit te Ofertave nuk mund te bazoje skualifikimin tone ne dokumenta te cilat nuk i ka kerkuar ne DST.

Ne vazhdim keni pretenduar se kamioncina me targe TR5429I dhe kamioncina me targe AA782DF nuk jane me kapacitet mbajtes dhe transportues mbi tre ton. Referuar ketij pretendimi shtrojme pyetjen ku jane kerkuar kamioncinat te kene kapacitet mbajtes dhe transportues mbi tre ton?? Pasi ne DST eshte kerkuar:

Kamioncine mbi 3 ton	në pronësi ose me qera	Cope 2
----------------------	------------------------	--------

Referuar kerkeses se mesiperme jane kerkuar dy kamioncina mbi tre ton, pra nuk eshte specifikuar ne asnje moment qe kamioncinat te jene me kapacitet mbajtes dhe transportues mbi tre ton e per pasoje nuk mund te skualifikohemi per gjera qe nuk jane kerkuar ne DST. Per te plotesuar kete kriter subjekti jone ka paraqitur dy kamioncina me kapacitet te pergjithshem deri ne 3,5 ton fakt i cili tregon se kriteri eshte plotesuar sipas DST-se.

Gjithashtu subjekti jone ka paraqitur dhe kamioncinen me targe TR5154L e cila ka bashkengjitur te gjithe dokumentacionin e kerkuar ne DST. Ne dokumentat standarte te tenderit nuk eshte kerkuar ne asnje moment as Leje transporti as licence per mjetet, e vetmja gje qe eshte kerkuar eshte:

a) Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

Pra referuar pikes se mesiperme dokumentacioni i kerkuar eshte paraqitur per mjetet e kerkuara. I njejti arsyetim vlen edhe per kamionat me targe AA258EV dhe VL5873C pasi per keta kamiona eshte paraqitur i gjithe dokumentacioni qe eshte kerkuar ne DST.

Referuar Neni 55 te LPP-se:

Neni 55

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

Referuar Ligjit "Per Prokurimin Publik" Nr. 9643, datë 20.11.2006, te ndryshuar, Neni 2 (Parimet e Perzgjedhjes) citojme:

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

b) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

Referuar pretendimit te fundit se ne skedarin SHTOJCA 5 7 10 te shtojca nr.10 kemi objekt tjetër dhe jo objektin e tenderimit, sqarojme se kemi ngaterruar emrin e objektit te prokurimit por ne shtojce, sic mund te vihet re, jane pasqyruar te gjitha pajisjet dhe makinerite e kerkuara per kete procedure prokurimi dhe per nje lapsus qe eshte bere te shtojca nga ana jone nuk eshte e drejte te skualifikohemi pasi te gjitha mjetet e kerkuar ne kete DST jane paraqitur nepermjet shtojces nr.10. Pra mjetet qe pershkruhen ne kete shtojce jane mjetet qe ju keni kerkuar e per pasoje jane per kete procedure prokurimi. Gjithashtu shtojca 10 eshte bashkengjitur me shtojcat e tjera per kete procedure prokurimi dhe eshte absurde te pretendohet se mjetet e deklaruar ne kete shtojce nuk jane per kete procedure prokurimi. Ligji per Prokurimin Publik parashikon ne nenin 53 pika 4 sa me poshte:

Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj. Gjithë sa me sipër duke vlerësuar se operatori ekonomik "Avduli" shpk ka përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim kërkojme nga ana e Autoritetit Kontraktor bazuar në Ligjin Nr. 9643, date 20.11.2006. "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar dhe ne VKM-ne nr.914 date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave per Prokurimin Publik" te ndryshuar te vendos per anullimin e vendimit te KVO-se dhe kualifikimin e shoqerise tone, pasi vendimi i Komisionit te Vleresimit te Ofertave eshte i padrejte dhe i pabazuar ne prova dhe ligj. Ne rast te kundert jemi te detyruar ti drejtohem Komisionit te Prokurimit Publik."

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1352/1 prot., datë 11.07.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit duke e refuzuar ankesën.

II.5. Në datën 22.07.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 02.08.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1284/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1454/1 prot., datë 29.07.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të shoqërisë “Avduli” sh.p.k se: “*Skedari me emertimin KAMIONCINE_TR_5429I_SHOQERIA_AVDULI_SHPK_VLORE i paraqitur nga OE, mjet ne pronesi të OE nuk plotëson kërkesën e AK që mjeti të jëtë me kapacitet mbajtës dhe transportues mbi 3 ton (fakt 2130 kg sipas lejes së qarkullimit mjetit).*

Sa më sipër, Operatori Ekonomik “AVDULI” Shpk, nuk plotëson një nga kriteret e DST, pika 2.3 Per kapacitetin teknik, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion... :

Skedari me emertimin KAMIONCINE_AA782DF-SHOQERIA_AVDULI_SHPK, i paraqitur nga OE tregon për mjetin e marrë me qira nga OE, i cili nuk plotëson kërkesën e AK që mjeti të jëtë me kapacitet mbajtës dhe transportues mbi 3 ton (fakt nen 700 kg sipas lejes së qarkullimit mjetit). Sa më sipër, Operatori Ekonomik “AVDULI” Shpk, nuk plotëson një nga kriteret e DST, pika 2.3 Per kapacitetin teknik, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion... :

Në Skedarin me emertimin KAMIONCINE_ME_QERA_SHOQERIA_AVDULI_SHPK_VLORE me targa TR5154 L, mungon liçenca kontraktorit (qeradhenesit), është paraqitur dokumentacioni mjetit, per te cilin (Per mjetin kamioncine, me targa TR5154 L), i marre me qira, nuk eshte paraqitur licence e Operatorit qiradhenës. Kjo vjen ne kundershjim me nenin 41(citim: Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.), te ligjit Nr. 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, te ndryshuar. Neni 5 Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës. Gjithashtu UDHËZIM-i Nr. 15, datë 24.7.2007, “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”, i ndryshuar, Neni 29, “Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira brenda vendit”, thuhet që: “Licenca për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit lëshohet për subjekte fizike dhe juridike”. Kjo licencë vlen edhe për transportin e mallrave për llogari të vet brenda vendit.

Sa më sipër, Operatori Ekonomik “AVDULI” Shpk, nuk plotëson një nga kriteret e DST, pika 2.3 Per kapacitetin teknik, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 12, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1, gërma “e” të dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, është parashikuar shprehimisht se:

1.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

[...] e. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10; [...]

III.1.2. Në shtojcën 10 të dokumentave të tenderit është përcaktuar shprehimisht plotësimi i deklaratës nga ofertuesit si më poshtë:

Shtojca 10

*[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]
 MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE*

Operatori ekonomik:_____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt:_____

<i>Në pronësi</i>				
<i>Lloji i Mjetit</i>	<i>Targa</i>	<i>Nr. Lejes qarkullimit</i>	<i>Nr. Shasisë</i>	<i>Të tjera</i>
<i>1</i>				
<i>2</i>				
<i>3</i>				
<i>4</i>				
<i>5</i>				

Dhe

<i>Me qera</i>					
<i>Lloji i Mjetit</i>	<i>Targa e mjetit</i>	<i>Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit</i>	<i>Nr. Shasisë së mjetit</i>	<i>Nr. Kont së qerasë (noterisë)</i>	<i>Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)</i>
<i>1</i>					
<i>2</i>					
<i>3</i>					
<i>4</i>					
<i>5</i>					
<i>6</i>					

- *shtofshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.*

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

III.1.3. Në shtojcën 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës së mëposhtme:

“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

<i>Nr</i>	<i>LLOJI I MAKINERIVE</i>	<i>PRONESIA</i>	<i>SASIA</i>
<i>1</i>	<i>Kamiona vetëshkarkues mbi 10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
<i>2</i>	<i>Kamioncine mbi 3 ton</i>	<i>në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
<i>3</i>	<i>Skele</i>	<i>ne pronesi ose me qera</i>	<i>2000 m2</i>
<i>4</i>	<i>Auto Vinç Lartësia e krahut (koshi) të jetë jo më e vogel se 12 m</i>	<i>ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
<i>5</i>	<i>Fadromë me goma</i>	<i>në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
<i>6</i>	<i>Motogjeneratorë</i>	<i>ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
<i>7</i>	<i>Auto Betoniere</i>	<i>në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 1</i>
<i>8</i>	<i>Betoniere</i>	<i>në pronësi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>
<i>9</i>	<i>Depozite uji (kapaciteti minimal 1000 litra)</i>	<i>ne pronesi ose me qera</i>	<i>Cope 2</i>

- a) Operatori Ekonomik te paraqese deklaraten sipas shtojces 10 (Deklarata e disponueshmërisë së makinerive)*
- b) Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates object i ketij prokurimi.*
- c) Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje ne çdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknike.*
- d) Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera, (Deklarate nga Administratori i Shoqerise Ofertuese). Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr.10. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se makineritë dhe pajisjet e paraqitura në shtojcën Nr. 10, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar në procedura të shpallura fitues. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi). Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa “a” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.*

e) *Shoqeria duhet te kete me qera ose te disponoje skeleri te certifikuar sipas Standarteve Europiane me garanci teknike per qendrueshmerine e skelave dhe te punimeve te montimit dhe cmontimit te tyre, konform KTZ (Kushteve Teknike te Zbatimit) sipas manualeve te montimit dhe projektit.”*

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së paraqitur nga operatorit ekonomik ankimues për këtë procedurë prokurimi në SPE, rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar për 2 kamioncina mbi 3 ton, është paraqitur si vijon:

- Deklaratë “Mbi disponimin e makinerive” e operatorit ekonomik ”Avduli” sh.p.k., ku ky i fundit deklaron se ka me qira 3 (tre) kamioncina për të realizuar kontratën me objekt: “Sistemim i shesheve dhe rrethim i varrezave të fshatrave Rranxa, Hajmel, Nenshate, Dheu i lehtë”. Sipas kësaj deklarate kamioncinat janë mjetet e marra me qira me targë TR 5154L, AA160MZ dhe AA782KC.
- Lidhur me këto mjete është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:
 - Kontratë qiraje nr.1411 Rep., nr.458 Kol., datë 25.05.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë “Bahas” sh.p.k., në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Avduli” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhenien me qira të mjetit me targë TR 5154L, shoqëruar me dokumentacionin përkatës: Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë TR 5154L; Leje qarkullimi; Certifikatë e kontrollit teknik; Siguracionin e mjetit;Foto e mjetit; Certifikatë nr.4220 datë 18.03.2015 ”Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”, lëshuar nga Bashkia Tiranë për shoqërinë ”Bahas” sh.p.k
 - Kontratë qiraje nr.1005Rep., nr.325 Kol., datë 11.04.2018, lidhur ndërmjet z.I.Menalla., në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Avduli” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhenien me qira të mjetit me targë AA 782 KC, shoqëruar me dokumentacionin përkatës: Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA782KC; Leje qarkullimi; Certifikatë e kontrollit teknik; Siguracionin e mjetit; Foto e mjetit;
 - Për mjetin me targë AA160MZ nuk është paraqitur dokumentacion.

III.1.5. Sipas ankimuesit pretendohet se: *“keni pretenduar se kamioncina me targe TR5429I dhe kamioncina me targe AA782DF nuk jane me kapacitet mbajtes dhe transportues mbi tre ton. Referuar ketij pretendimi shtrojme pyetjen ku jane kerkuar kamioncinat te kene kapacitet mbajtes dhe transportues mbi tre ton?? Pasi ne DST eshte kerkuar:*

Kamioncine mbi 3 ton	në pronësi ose me qera	Cope 2
----------------------	------------------------	--------

Referuar kerkeses se mesiperme jane kerkuar dy kamioncina mbi tre ton, pra nuk eshte specifikuar ne asnje moment qe kamioncinat te jene me kapacitet mbajtes dhe transportues mbi tre ton e per pasoje nuk mund te skualifikohemi per gjera qe nuk jane kerkuar ne DST. Per te plotesuar kete kriter subjekti jone ka paraqitur dy kamioncina me kapacitet te pergjithshem deri ne 3,5 ton fakt i cili tregon se kriteri eshte plotesuar sipas DST-se.

Gjithashtu subjekti jone ka paraqitur dhe kamioncinen me targe TR5154L e cila ka bashkengjitur te gjithe dokumentacionin e kerkuar ne DST. Ne dokumentat standarte te tenderit nuk eshte kerkuar ne asnje moment as Leje transporti as licence per mjetet, e vetmja gje qe eshte kerkuar eshte:

a) Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

Pra referuar pikes se mesiperme dokumentacioni i kerkuar eshte paraqitur per mjetet e kerkuara. I njeiti arsyetim vlen edhe per kamionat me targe AA258EV dhe VL5873C pasi per keta kamiona eshte paraqitur i gjithë dokumentacioni qe eshte kerkuar ne DST.”

III.1.6. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.1.7. Në nenin 26, pika 8/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.1.8. Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të vërtetojnë se zotërojnë 2(dy) kamionciona mbi 3 ton. Dokumentacioni që e vërteton përmbushjen e këtij

kapaciteti është deklarata që plotësohet nga ofertuesi sipas shtojces 10 (Deklarata e disponueshmërisë së makinerive), në të cilën nga ana e tij deklarohen mjetet dhe pajisjet në zotërim (me qira apo në pronësi) që do të angazhohen në këtë procedurë prokurimi. Për këto mjete të deklaruar paraqitet dokumentacioni përkatës që në rastin konkret për kamioncinat është dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Në verifikim të përmbushjes së kriterit për mjetet kamioncinë, që është edhe një nga arsyet e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik “Avduli” sh.p.k, rezulton se, ky i fundit ka paraqitur deklaratën mbi disponimin e mjeteve, ku deklaron se për objektin e prokurimit “*Sistemim i shesheve dhe rrethim i varrezave të fshatrave Rranxa, Hajmel, Nenshate, Dheu i lehtë*”, zotëron 3 (tre) kamioncina, të marrë me qira dhe konkretisht mjetet me targë TR 5154L, AA160MZ dhe AA782KC.

Së pari konstatohet se objekti për të cilin është paraqitur kjo deklaratë “*Sistemim i shesheve dhe rrethim i varrezave të fshatrave Rranxa, Hajmel, Nenshate, Dheu i lehtë*”, nuk përputhet me objektin e prokurimit në fjalë, objekt shqyrtimi “*Zbatimi Projekt-Preventivitet për Eficiency e Energjisë i Ndërtesës Ekzistuese 4-KT, në Bashkëpronësi, Pallati nr. 3 (Fizarmonike), Lagje 1, në Qëndër të Qytetit Krumë*”. Lidhur me këtë fakt ankimuesi sqaron se ka ngatërruar emrin e objektit të prokurimit por sipas tij, në shtojcë, sic mund të vihet re, janë pasqyruar të gjitha pajisjet dhe makineritë e kërkuara për këtë procedurë prokurimi dhe për një lapsus që është bërë tek shtojca nga ana jonë nuk është e drejtë të skualifikohemi pasi të gjitha mjetet e kërkuar në këtë DST janë paraqitur nëpërmjet shtojcës nr.10. Pra mjetet që përshkruhen në këtë shtojcë janë mjetet që ju keni kërkuar dhe për pasojë janë për këtë procedure prokurimi.

Së dyti, rezulton se ankimuesi, ka dorëzuar dokumentacionin përkatës vetëm për 2 nga 3 mjetet e deklaruar për të cilat ankimuesi në ankesë sqaron se janë mjetet që përshkruhen në këtë shtojcë (shtojca 10), mjetet që janë kërkuar nga AK e për pasojë janë për këtë procedurë prokurimi. Konkretisht ka paraqitur dokumentacion për mjetet me targë TR 5154L dhe AA782KC ndërsa për mjetin me targë AA160MZ nuk është paraqitur dokumentacion.

Për dy mjetet e deklaruar me targë TR 5154L dhe AA782KC është paraqitur dokumentacioni përkatës (kontratë qiraje, certifikata e pronësisë, leje qarkullimi të mjeteve përkatëse, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni etj). Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit për mjetet kamioncina, konkretisht, për mjetet me targa TR 5154L dhe AA782KC, referuar lejes së qarkullimit të secilit mjet, rezulton se mjeti me targë AA782KC ka një kapacitet më të ulët se 3 ton. Masa maksimale e tij e autorizuar është 2800 dhe masa e mjetit bosh është 2182.

Përsa i përket mjetit me targë TR 5154L rezulton se është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Ndërsa për mjetin me targë AA160MZ, megjithëse është deklaruar në ofertë, sipas shtojcës 10, nuk është paraqitur dokumentacion.

Përsa i përket pretendimeve për mjetin kamioncina me targe TR5429I, konstatohet se në deklaratën “Mbi disponimin e makinerive” të paraqitur në ofertën e operatorit ekonomik “Avduli” sh.p.k., nuk rezulton të jetë përfshirë ky mjet.

Si rrjedhim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar shprehimisht kriteri që, duhet të paraqitet dokumentacioni i nevojshëm për 2 mjete kamioncina mbi 3 ton, konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të vërtetojë se disponon mjete të tilla duke mos e plotësuar kështu kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për mjetet kamioncinë.

III.1.11. Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentat e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Sa më sipër analizuar, konstatohet se, jemi në kushtet kur nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është plotësuar kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor në lidhje me dokumentacionin për mjetet kamioncina, pasi, në rastin konkret operatori ekonomik ankimues nuk e disponon atë në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Avduli” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Avduli” sh.p.k., për procedurën e prokurimit me Nr.REF-20370-05-02-2019, me objekt: “Zbatimi Projekt-Preventiv për Efijencën e Energjisë i Ndërtesës Ekzistuese 4-KT, në Bashkëpronesi, Pallati nr. 3 (Fizarmonike), Lagje 1, ne Qëndër të Qytetit Krumë”, me fond limit 25.785.910 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 07.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Has.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1284 Protokolli

Datë 22.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha